

#FS4EU

#foodsafety

#foodsystem

#FoodSafety4EU

Platforma europiane në forcim të bashkëpunimit të sigurisë ushqimore

Një ushqim i sigurt dhe i shëndetshëm është çelësi për të rritur cilësinë e jetës. Thënë kjo, sistemi aktual i sigurisë ushqimore europiane paraqet mangësi, kur i duhet të adaptohet me shpejtësi dhe në vazhdimësi me zhvillimet e zinxhirëve ushqimor, duke sjellë në këtë mënyrë mungesë besimi te konsumatorët përballë autoriteteve të sigurisë ushqimore.

Projekti european FoodSafety4EU i financuar nga HORIZON 2020 dhe në koordinim me CNR ISPA të Barit, ka si synim që të përballlet me këto pika të dobëta, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe përfshirjes së të gjithë aktorëve të sigurisë ushqimore të Europës.

I nisur në Janar të 2021 ky projekt, synon të hartojë dhe të zhvillojë një platformë multi-aktoriale, për të krijuar një rrjet bashkëpunimi ndërmjet konsumatorëve, kërkuesve shkencorë dhe vendimmarrësve politikë në nivel kombëtar, europian dhe ndërkombëtar, me qëllim funksionimin sa më të mirë të sigurisë ushqimore.

Për të lehtësuar këtë lloj bashkëpunimi, ndërmjet aktorëve të ndryshëm, projekti do të zhvillojë metoda me instrumente dixhitale për strukturimin e procesit të pjesëmarrjes, si dhe fushatave të komunikimit për të përfshirë në mënyrë aktive konsumatorët në sistemin e sigurisë ushqimore.

Më specifikisht projekti FoodSafety4EU do të ndihmojë në:

- Reduktimin e fragmentarizimit të sistemit të sigurisë ushqimore, duke ngritur ura bashkëpunimi ndërmjet konsumatorëve, vendimmarrësve dhe kërkuesve shkencorë
- Projekti do të mbështesë Komisionin European dhe Autoritetin e Sigurisë Ushqimore Europiane për të përballuar problemet aktuale me sigurinë ushqimore edhe falë këshillimeve shkencore
- Mbështetje të Komisionit European dhe Autoritetit të Sigurisë Ushqimore Europiane duke adresuar problemet aktuale të sigurisë ushqimore dhe duke dhënë rekomandimet e duhura.

- Formati i hapur dhe i disponueshëm i të dhënave sa i përket sigurisë ushqimore, për të rritur besimin e konsumatorëve kundrejt autoriteteve të sigurisë ushqimore
- Venia në dispozicion e të dhënave të disponueshme në një format të hapur, me qëllim rritjen e besimit të konsumatorit kundrejt autoriteteve të sigurisë ushqimore

FoodSafety4EU në një rrjet të gjërë European i përbërë nga 23 partnerë, subjekte përfituese dhe 44 palë të interesit, (Autoritete të Sigurisë Ushqimore, Shoqata konsumatorësh dhe Qendra Kërkimi që mbështesin projektin).

Ky rrjet ka një strukturë të hapur ku mund të bëhesh pjesë në çdo kohë, motiv ky që komuniteti ynë të rritet në harkun kohor të tre viteve, me qëllimin e vetëm rritjen e kapaciteteve të sigurisë ushqimore në funksion të besimit të konsumatorit.

Për informacione të mëtejshme mund të vizitoni faqen zyrtare: <https://foodsafety4.eu/>



@FS4EU



[ëëë.linkedin.com/company/foodsafety4eu/](https://www.linkedin.com/company/foodsafety4eu/)